



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 630, datë 29.10.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10, DATË 18.01.2024 “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI, PËR VITIN 2024” TË NDRYSHUAR, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 62, pika 13 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 170, datë 28.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, vendimin nr. 10, datë 18.01.2024, vendimin nr. 488, datë 13.09.2024, vendimin nr.625, datë 22.10.2024 dhe vendimin nr. 626, datë 22.10.2024 të KLGJ-së; me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, dhe pas procedurës së shortit,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 10, datë 18.01.2024, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:
1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2024, është si më poshtë:
 1. Znj. Yllka Rupa – Kryetare;
 2. Znj. Irena Plaku – anëtar;
 3. Z. Albens Tabaku – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Z. Markelian Koça – anëtar;
2. Z. Bledar Bajri – anëtar;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR